



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERISTAR

Nr. 1726 prot.

Tiranë, më 07 / 07 / 2025

URDHËR

Nr. 143, datë 07 . 07 . 2025

PËR

PËRCAKTIMIN E AFATEVE TË REGJISTRIMEVE TË NXËNËSVE

Në zbatim të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr.249, datë 30.04.2025 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime të vendimit nr.742, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave “ Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP)”, urdhrit nr 300 datë 19.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për disa ndryshime të urdhrit nr. 31, datë 28.01.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit nr.589 datë 16.10.2023 “Për miratimin e rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar”,

URDHËROJ:

- 1.Regjistrimi në klasë të parë dhe në klasë të dhjetë bëhet nëpërmjet portalit e-albania, nga 07 korrik - 31 gusht 2025.
- 2.Regjistrimi në shkollat artistike dhe ato sportive bëhet nëpërmjet portalit e-albania, nga 07 korrik - 31 gusht 2025.
- 3.Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar si dhe institucionet publike/private të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Rezarta ALLA

